



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë nën asistencën e specialistëve të Misionit
EURALIUS)*

(Mbajtur, më 16.04.2020)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave: 7.02.2020, 20.02.2020, 24.02.2020, 26.02.2020, 27.02.2020, 2.03.2020, 6.03.2020 dhe 10.03.2020.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:16 dhe mbaroi në orën 15:54.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 7. Ilir Toska** (anëtar)
- 8. Alban Toro** (anëtar)
- 9. Brikena Ukperaj** (anëtar)

10. Erjon Muharremaj (anëtar)

11. Marçela Shehu (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 5. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*

RENDI I DITËS:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave: 7.02.2020, 20.02.2020, 24.02.2020, 26.02.2020, 27.02.2020, 2.03.2020, 6.03.2020 dhe 10.03.2020.

Mbledhja plenare e datës 16 prill 2020 fillon me prezantimin e pikave të rendit të ditës nga Kryetarja së Këshillit, zonja Naureda Llagami e cila, në cilësinë edhe të Kryetares së Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit i propozon mbledhjes plenare shtimin në pikën e pestë të rendit të ditës edhe të një projektvendimi të marrë nga ana e këtij Komisioni një ditë më parë lidhur me miratimin e fondeve të lira, nga buxheti i vitit 2020 për sistemin gjyqësor, duke u shqyrtuar kështu të dy këto projekt-akte të cilat kanë lidhje njëra me tjetrën.

Zoti Alban Toro merr fjalën dhe kërkon të dijë se cili është ndryshimi i lëndës së këtij projekt-akti të propozuar nga ky Komision me projekt-aktin e pikës së pestë të rendit të ditës dhe gjithashtu cila është urgjenca, pasi zoti Toro e ka kërkuar këtë gjë para 1 muaji. Pra zoti Toro kërkon të dijë ku dallon propozimi i parë me propozimin e dytë.

Për t'iu përgjigjur pyetjeve të zotit Toro, zonja Llagami kërkon që çështja të futet njëherë në rendin e ditës dhe më pas të kalohet në trajtimin e kësaj çështjeje.

Zonja Brunilda Kadi merr fjalën dhe është dakord që të futet kjo çështje për t'u trajtuar në rendin e ditës dhe më pas kur të vijë momenti i trajtimit të çështjes 5, të shikohet se si do mund të bashkohen këto propozime.

Zonja Brikena Ukperaj merr fjalën për të shpjeguar ndryshimin e dy akteve, ku njëri akt është vënë në lëvizje kryesisht nga 5 anëtarë të Këshillit, ndërsa akti tjetër që Kryetarja propozon të fusë në rendin e ditës është vënë lëvizje nga kërkesa e Ministrisë së Financave. Gjithashtu edhe zonja Ukperaj është dakord që kjo çështje të futet për trajtim në rendin e ditës.

Gjithashtu, **zonja Marçela Shehu** kërkon një sqarim sa i përket, nëse çështja futet në rendin e ditës, do jetë një çështje më vete apo do përfshihet në çështjen e pestë të rendit të ditës dhe në përgjigje të kësaj, zonja Llagami sqaron edhe një herë që kjo çështje duke qenë se ka lidhje me çështjen e pestë të rendit të ditës, do të trajtohet në atë pikë të rendit të ditës.

Pas diskutimeve, hidhet në votim propozimi për futjen në rendin e ditës të projektvendimit të propozuar nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit “Mbi miratimin e fondeve të lira, nga buxheti i vitit 2020, në sistemin gjyqësor”, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është kundër.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Ilir Toska është dakord.

Alban Toro është kundër, për çka tha më sipër.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Me shumicë votash miratohet futja në rendin e ditës, në pikën e pestë të tij, e propozimit të bërë nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Merr fjalën **zonja Kadi**, e cila kërkon që të përfshihet në rendin e ditës edhe një çështje, dokumenti i të cilës është dërguar nga ana e Kryetares së Këshillit, nëpërmjet e-mailit, në orën 1:39 të mëngjesit, dokument i përcjellë nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë. Zonja Kadi shton se edhe pa ardhur kjo shkresë, si anëtare e Komisionit që është krijuar për menaxhimin e çështjeve të prapambetura në Gjykatën e Lartë, bashkë me zotin Toro, do e kërkonim të trajtohej kjo problematikë.

Zonja Llagami sqaron se mënyra sesi Këshilli dhe Komisionet po operojnë për mbarëvajtjen e punës në këtë periudhë, është duke punuar *online*, dhe të gjitha informacionet që protokollohen shpërndahen nëpërmjet e-mailit edhe tek anëtarët për vlerësim, për dijeni, për të gjykuar nëse ka çështje të cilat duhen trajtuar dhe kanë apo jo urgjencë. Rasti konkret për të cilin po flitet është shpërndarë tek anëtarët në momentin e krijimit të mundësisë nga ana e Kryetares së Këshillit, për t'u vlerësuar dhe konsultuar nga ana e anëtarëve nëse ishte apo jo një çështje urgjente dhe pse jo, me propozimin e tyre të futej në një nga mbledhjet plenare për trajtim por që sot, nuk është një çështje e rendit të ditës për sa kohë nuk ka ardhur një vlerësim dhe nuk është përpunuar praktika.

Merr sërish fjalën **zonja Kadi** e cila shprehet se nuk duhet paragjykuar vendimmarrja e Këshillit dhe se ky ishte një propozim i ardhur nga ajo si anëtare. Në lidhje me urgjencën e këtij dokumenti, sqaron se edhe çështja që u votua më parë për t'u shtuar në rendin e ditës, ishte urgjente dhe gjithashtu rithekson edhe një herë rëndësinë që ka kjo shkresë e Presidentit të Republikës për t'u trajtuar dhe për t'u shtuar në rendin e

ditës, pasi sipas mendimit të saj, është një shqetësim, që një anëtar i Gjykatës së Lartë, vazhdon detyrën në pozicion përtej ligjit.

Në lidhje me këtë çështje, merr fjalën **zoti Toro**, i cili rikujton në mbledhje Memorandumin e Mirëkuptimit në lidhje me nismën për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në Gjykatën e Lartë, Memorandum i cili, me autorizim do të firmoset në datën 17 prill (pra nesër) nga Kryetarja e Këshillit dhe nënshkruesi për Gjykatën e Lartë është zoti {...}, i cili nuk gëzon më statusin e magjistrat, ndërkohë që në Gjykatën e Lartë janë emëruar tashmë 3 anëtarë të rinj të cilët mund të përzgjedhin ndërmjet njëri-tjetrit nënshkruesin e këtij Memorandumi.

Në përgjigje, **zonja Llagami** shprehet se interesi publik sot është se ç'po bën Këshilli i Lartë Gjyqësor me gjykatat në kushte pandemie, ku me ndërgjegje është bërë pezullimi i veprimtarisë së gjykatave, për të mbrojtur jetën e njerëzve në gjykata. Zonja Llagami kërkon që Këshilli të fokusohet tek çështjet urgjente që kanë lidhje me situatën e pandemisë, e këtu përgëzon propozimin e ardhur nga 3 anëtarë për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm i cili do të merret me masat që duhet të merren për ushtrimin e veprimtarisë e shërbimeve gjyqësore në gjykata të cilat duhet të operojnë në kushte pandemie. Zonja Llagami është e mendimit që kjo çështje nuk është një çështje për rendin e ditës, pasi shkresa ka ardhur vetëm një ditë më parë dhe duhet diskutuar një herë nga Komisionet përkatëse. Detyra e këtij Këshilli sot është të marrë masa ndaj gjyqësorit në kushte pandemie dhe çështjet që janë futur në rendin e ditës janë çështje urgjente, për të cilat duhet të kihet ndjeshmëri më të lartë nga i gjithë Këshilli, pasi edhe e gjithë bota sot e ka sfidë pjesën e gjyqësorit dhe në botë nuk pezullohet veprimtaria në gjykata por kërkohet që të merren masa që gjyqtarët të punojnë të sigurt dhe që t'i krijohet akses në drejtësi qytetarëve, ndërsa çështja që propozohet sigurisht që do të jetë pjesë e një mbledhjeje tjetër e afërt.

Në vijim merr fjalën **zonja Kadi** e cila propozon që kjo çështje të shqyrtohet në fund të rendit të ditës, pasi të shqyrtohen çështjet e emergjencës. Ajo shprehet se

Kryetarja e Këshillit duhet të hedhë në votë propozimin e bërë nga dy anëtarë të Këshillit.

Merr fjalën më pas **zonja Shehu** e cila bën një përmbledhje të çka u tha nga zonja Kadi më lart dhe thekson se ora në të cilën është dërguar e-maili nga ana e Kryetares së Këshillit, nënkupton që shkresa ka përcjellë një urgjencë dhe më pas është dërguar tek anëtarët e Këshillit. Zonja Shehu i referohet më pas nenit 67 të ligjit 115/2016 i cili thotë se një çështje futet në rendin e ditës nëse ajo kërkohet të futet nga jo më pas se 6 anëtarë, prandaj nëse anëtarë të tjerë vlerësojnë që kjo çështje të futet në rendin e ditës, atëherë kjo çështje duhet të futet në rendin e ditës. Ndërsa lidhur me thirrjen e bërë sa i përket sensibilizimit, shqetësimit që duhet të ketë Këshilli lidhur me situatën, zonja Shehu përgëzon Misionin EURALIUS për propozimin e krijimit të këtij Komisioni të Përkohshëm në këtë situatë pandemie dhe në përfundim shton se personalisht është shumë e shqetësuar, ashtu si edhe kolegët, që të merren të gjitha masat e duhura për mbarëvajtjen e gjyqësorit. Gjithashtu ajo propozon që të hidhet në votim propozimi i zonjës Kadi dhe zotit Toro për shtimin e çështjes në rendin e ditës.

Sa i përket orarit të dërgimit të e-mailit, **zonja Llagami** sqaron që nuk është çështje urgjence, por në atë e-mail janë dërguar edhe dokumente të tjera, pra orari nuk tregon një urgjencë por tregon disponibilitetin e saj për të punuar në atë orar dhe për të shpërndarë praktikat në drejtim të stafit administrativ dhe anëtarëve.

Edhe **zoti Hallunaj**, në lidhje me këtë çështje, shprehet se është i papërgatitur për të trajtuar këtë çështje, për ta futur apo jo në rendin e ditës apo për t'u shprehur për thelbin, pasi nuk ka një material mbi të cilin të vlerësojë dhe të japë një mendim e më pas të votojë.

Merr fjalën **zoti Toska** i cili shprehet se shkresa të cilën ka përcjellë Presidenti i Republikës është një çështje sensitive dhe Këshilli do duhet ta trajtojë. Zoti Toska shtron disa pyetje anëtarëve të tilla si: A duhet të kë në anëtarët një material përpara? A duhet të ketë një vendimmarrje? A duhet ta trajtojë çështjen një Komision i caktuar apo një grup

anëtarësh që t'i propozojnë Këshillit për diskutim apo për vendimmarrje? Sipas zotit Toska, duhet një ditë apo dy ditë kohë për të përgatitur diçka për Këshillin. Gjithashtu zoti Toska jep mendim edhe për çështjen e nënshkrimit të Memorandumit, duke u shprehur se mund të shtyhet për një ditë tjetër.

Zonja Kadi e mbështet mendimin e zotit Toska duke ripërsëritur edhe një herë mbi shkeljen e ligjit nëse nuk hidhet në votim propozimi i bërë nga dy anëtarët e Këshillit për të futur në rendin e ditës çështjen për të cilën po flitet.

Më pas merr fjalën **zonja Ukperaj** e cila ngre për diskutim nëse kjo çështje është nga ato çështje të cilat duhet të përfshihen në rendin e ditës. Mendimi i saj është për t'u njohur me shkresën e më pas të vlerësohet nëse është një çështje e cila i takon mbledhjes plenare të Këshillit, për t'u futur në rend dite apo jo?!

Zoti Toro i rikthehet edhe një herë pjesës së nënshkrimit të Memorandumit, duke ritheksuar që një person që s'ka tagër, nuk duhet të firmosë Memorandumin.

Edhe **zonja Fatmira Luli** mendon se Memorandumi mos të firmoset në datën që është përcaktuar për t'u firmosur por të shtyhet derisa të vendosi Komisioni i Karrierës, siç ka vendosur për anëtarët e tjerë për mbarimin e mandatit.

Në përfundim, Kryetarja e Këshillit hedh në votim propozimin për futjen e kësaj çështjeje në rendin e ditës dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është kundër.

Iilir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është kundër.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është kundër.

Me shumicë votash miratohet futja në rendin e ditës e diskutimit të kësaj çështjeje.

Fillon çështja e parë e rendit të ditës e cila relatohet nga Kryetarja e Këshillit dhe ka të bëjë me miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave: 7.02.2020, 20.02.2020, 24.02.2020, 26.02.2020, 27.02.2020, 2.03.2020, 6.03.2020 dhe 10.03.2020.

Pasi pyeten anëtarët e Këshillit nëse kanë ndonjë koment për procesverbalet e përcjella me e-mail dhe nga anëtarët nuk kishte komente, hidhet në votim miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të sipërpërmendura dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord, me komentin që sipas nenit 69/3 e ligjit 115/2016 procesverbali duhet t'i përcillet anëtarëve sipas afateve që thotë ligji, me qëllim që të miratohen mbledhjen pasardhëse. Është bërë e zakonshme që sillen disa procesverbale njëherësh dhe duke qenë shumë është e vështirë për anëtarët që t'i mbajnë mend se çfarë kanë thënë në mënyrë që të pasqyrohen të gjitha ato situata korrekte që janë diskutuar. Gjithashtu zonja Kadi ngre shqetësimin e publikimive të mbledhjeve audio, ku ende ka shumë audio të mbledhjeve të pahedhura online. Sipas zonjës Kadi është duke u shkelur ligji me mospublikimin e audiove. Para 1 viti iu është thënë anëtarëve që nuk e lejon faqja e internetit që të aplodohen mbledhjet audio, ndërkohë që tani, Këshilli ka një faqe të re ku mund të aplodohen audiot e të gjitha mbledhjeve të Këshillit.

Dritan Hallunaj është dakord, por kërkon që gjatë votimit duhet të votohet dhe kur të diskutohet duhet të diskutohet. Zoti Hallunaj shprehet se anëtarët e Këshillit ishin në votim dhe duhet të votonin. Nëse dikush është kundër, bën shpjegim të votës kundër.

Illir Toska është dakord.
Alban Toro është dakord.
Fatmira Luli është dakord.
Marçela Shehu është dakord.
Erjon Muharremaj është dakord.
Brikena Ukperaj është dakord.
Medi Bici është dakord.
Naureda Llagami, është dakord.

Në përfundim Këshilli i Lartë Gjyqësor, vendosi miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave: 7.02.2020, 20.02.2020, 24.02.2020, 26.02.2020, 27.02.2020, 2.03.2020, 6.03.2020 dhe 10.03.2020. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi dhe publikimin e këtyre procesverbaleve Kryetarja e Këshillit. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Për sqarim, në përfundim të çështjes, zonja Llagami shprehet se audiot janë të publikuara në faqen zyrtare. Gjithashtu po publikohen intensivisht audiot e mbledhjeve të mëparshme. Më parë, uebsajti i Këshillit nuk mundësonte aplodimin e audiove dhe prandaj Këshilli ishte i detyruar të kalonte në një procesverbal narrativ ku të shkruheshin të gjitha gjërat. Ndërsa aktualisht, me uebsajtin e ri, mundësuar nga Projekti “Justice for all”, në datën 5 shkurt 2020 audio hidhet drejtpërdrejt në faqe. Ndërsa në lidhje me shkeljen e ligjit, zonja Llagami informon se çdo qytetar që e ka kërkuar audion, i është vënë në dispozicion nga ana e Këshillit procesverbali dhe CD-ja audio e mbledhjes.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë nën asistencën e specialistëve të Misionit
EURALIUS)*

(Mbajtur, më 16.04.2020)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për hartimin, propozimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të një plani masash për ushtrimin e veprimtarisë e shërbimeve gjyqësore në mënyrën më të sigurt të mundshme gjatë kohëzgjatjes së epidemisë së shkaktuar nga virusi Covid-19”.

- Zgjedhja e anëtarëve të Komisionit të Përkohshëm.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:16 dhe mbaroi në orën 15:54.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi*** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj*** (anëtar)
- 7. Ilir Toska*** (anëtar)

8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
11. *Marçela Shehu* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtoresh pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
5. *Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për hartimin, propozimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të një plani masash për ushtrimin e veprimtarisë e shërbimeve gjyqësore në mënyrën më të sigurt të mundshme gjatë kohëzgjatjes së epidemisë së shkaktuar nga virusi Covid-19”.

- Zgjedhja e anëtarëve të Komisionit të Përkohshëm.

Relator i kësaj çështjeje është zonja Brikena Ukperaj. Projekt-akti është iniciativë e tre anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor: z. Dritan Hallunaj, znj. Brikena Ukperaj dhe z. Erjon Muharremaj.

Ky projektvendim është realizuar nisur nga problematikat e shfaqura në gjyqësor ku secila nga gjykatat e ka zgjidhur në mënyrë të pavarur çështjen e administrimit të gjykatës, nisur edhe nga propozimi i bërë nga Misioni EURALIUS, tre anëtarët e Këshillit z. Dritan Hallunaj, znj. Brikena Ukperaj dhe z. Erjon Muharremaj kanë sjellë për diskutim në mbledhjen plenare projekt-aktin “Për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për hartimin, propozimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të një plani masash për

ushtrimin e veprimtarisë e shërbimeve gjyqësore në mënyrën më të sigurt të mundshme gjatë kohëzgjatjes së epidemisë së shkaktuar nga virusi Covid-19”.

Merr fjalën zonja Ukperaj e cila lexon relacionin shpjegues lidhur me përmbajtjen e projektvendimit të sipërcituar. Ndër të tjera, në relacion i propozohet Këshillit krijimi i një Komisioni të Përkohshëm me tre anëtarë (2 anëtarë gjyqtarë dhe një anëtar jogjyqtar), me kompetenca hartimin, propozimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të planit të masave të miratuara nga Mbledhja Plenare, për të menaxhuar më së miri këtë situatë të krijuar nga përhapja e infeksionit Covid-19. Ky Komision duhet të kryejë analizën e kuadrit ligjor në fuqi dhe të bashkëpunojë me këshillat e gjykatave, kryetarët dhe kancelarët e tyre, për të evidentuar të gjitha problematikat që shfaq infrastruktura e gjykatave, me synimin e hartimit të një plani masash që kufizon sa më shumë të jetë e mundur efektet negative që epidemia shkakton në aktivitetet gjyqësore, por duke marrë parasysh nga ana tjetër, garantimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor.

Merr fjalën *zoti Erjon Muharremaj* i cili falënderon ndihmën e dhënë nga dy partnerët ndërkombëtarë që asistojnë Këshillin: Misioni EURALIUS V dhe Projekti “Drejtësi për të gjithë”.

Merr fjalën *zonja Marçela Shehu* e cila pasi falënderon propozimin e ardhur nga Misioni EURALIUS dhe asistencën e tyre juridike e teknike si dhe falënderon anëtarët të cilët e sollën projekt-aktin në mbledhje për miratim, propozon që përbërja e Komisionit të mos jetë me 3 anëtarë, por me 5 anëtarë, duke qenë se edhe ligji, neni 62 nuk përcakton numër mbi përbërjen e komisioneve. Gjithashtu sipas saj, duke qenë se bën pjesë edhe në një tjetër Komision që është i përbërë nga 5 anëtarë, mendon se është shumë funksional (edhe pse punohet online).

Zonja Ukperaj, në përgjigje të çka propozoi zonja Shehu, shprehet se Komisioni mund të jetë më funksional duke punuar me 3 anëtarë. Gjithsesi të hidhet në votim.

Duke qenë se anëtarë të tjerë nuk kanë propozime të tjera, fillimisht hidhet në

votim nga Kryetarja e Këshillit propozimi i bërë nga zonja Shehu mbi përbërjen e Komisionit të Përkohshëm, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord në tërësi me aktin, por kundër për 5 anëtarë (duke qenë një nga propozuesit e aktit, ku Komisioni të përbëhet nga 3 anëtarë)

Iilir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është kundër (duke qenë një nga propozuesit e aktit, ku Komisioni të përbëhet nga 3 anëtarë).

Brikena Ukperaj është kundër (duke qenë një nga propozuesit e aktit, ku Komisioni të përbëhet nga 3 anëtarë).

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Hidhet në votim më pas Kryetarja e Këshillit i gjithë akti në tërësi, bashkë me propozimin e bërë nga zonja Shehu, i cili u votua më lart. Rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Iilir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është kundër.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim Këshilli i Lartë Gjyqësor, vendosi: 1. Ngritjen e një Komisioni të Përkohshëm për hartimin, propozimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të një plani masash organizative dhe administrative, me qëllim ushtrimin e veprimtarive e shërbimeve gjyqësore në mënyrën më të sigurt të mundshme gjatë kohëzgjatjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.

2. Komisioni i Përkohshëm përbëhet nga 5 anëtarë, 2 anëtarë jogjyqtarë dhe 3 anëtarë gjyqtarë, të zgjedhur nga Mbledhja Plenare.

3. Në përmbushje të detyrave të tij sipas pikës 1, Komisioni i Përkohshëm kryen analizën e kuadrit ligjor në fuqi dhe bashkëpunon me këshillat e gjykatave, kryetarët dhe kancelarët e tyre, për të evidentuar të gjitha problematikat që shfaq infrastruktura e gjykatave, me synimin e kufizimit të efekteve negative që epidemia shkakton në ushtrimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore.

4. Masat e propozuara nga Komisioni i Përkohshëm e të miratuara nga Mbledhja Plenare, mund të zhvillohen e ndryshojnë në dinamikë, në varësi të ecurisë së epidemisë.

5. Komisioni i Përkohshëm ushtron veprimtarinë e tij deri në përfundim të gjendjes së epidemisë.

6. Në mbledhjet e tij Komisioni mund të ftojë të marrin pjesë përfaqësues të Misionit EURALIUS V, dhe të projektit “Drejtësi për të gjithë”-USAID.

7. Në përmbushjen e punës së tij Komisioni do të asistohet nga stafi administrativ i Këshillit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Sa i përket zgjedhjes së anëtarëve të Komisionit të Përkohshëm, pas disa diskutimeve nëse do të përzgjidhen nëpërmjet shortit apo nëpërmjet propozimeve të bëra nga vetë anëtarët, anëtarët e Këshillit vendosin që përzgjedhja e 5 anëtarëve të Komisionit të bëhet nëpërmjet shortit me shiritat e letrës të cilat hidhen në një vazo qelqi, duke përjashtuar emrin e zotit Toska, propozim i ardhur nga zonja Shehu, për shkak të gjendjes fizike jo të mirë të tij.

Rezultatet e shortit janë si më poshtë:

Z. Medi Bici, znj. Brunilda Kadi dhe znj. Marçela Shehu (nga anëtarët gjyqtarë).

Znj. Naureda Llagami dhe z. Erjon Muharremaj (nga anëtarët jo gjyqtarë).

Në përfundim, Këshilli vendosi që anëtarët përbërës të këtij Komisioni do të jenë:

Znj. Naureda Llagami – Kryetare e Komisionit;

Z. Medi Bici – Anëtar i Komisionit;

Znj. Brunilda Kadi – Anëtare e Komisionit;

Znj. Marçela Shehu - Anëtare e Komisionit;

Z. Erjon Muharremaj - Anëtar i Komisionit.

Hidhet në votim rezultati i shortit. Rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Illir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është kundër.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Pas votimit të kësaj pike, **zonja Shehu** merr fjalën për t'u shprehur lidhur me iniciativën që kishte marrë zoti Erjon Muharremaj, për përdorimin e programit kompjuterik “Skajp for Biznes” (“Skype for Business”), iniciativë e marrë kjo pa vullnetin e Këshillit dhe pa qenë ky një propozim i dalë nga Komisioni i ngritur pikërisht më parë. Zonja Shehu përgëzon për tërheqjen e këtij propozimi nga ana e tij. Të njëjtin

mendim ka edhe *zonja Kadi* e cila edhe ajo e përgëzon për iniciativën duke menduar se dëshira ka qenë me qëllim të mirë, por gjithsesi jep mendimin e saj se nuk mund të veprohet në emër të Këshillit pa patur autorizimin e Këshillit.

Zoti Muharremaj merr fjalën dhe shprehet mbi arsyen e tërheqjes së propozimit, arsye e cila nuk ishte për shkak të mosmarrjes së pëlqimit nga ana e kolegëve. Ai është i mendimit se për të bërë diçka që i vlen të gjithë sistemit gjyqësor veprohet edhe me iniciativën personale, pavarësisht pëlqimit formal të kolegëve. Iniciativa ishte thjesht për të eksploruar mundësinë më të mirë që të garantohej komunikimi në distancë i gjykatave në zbatim të aktit normativ. Iniciativa ishte në cilësinë e anëtarit të Këshillit dhe jo në cilësinë e përfaqësuesit të Këshillit,

Zoti Hallunaj mendon se situata është e tillë dhe e përgëzon zotin Muharremaj për iniciativën e marrë sepse Kodi i ka përcaktuar mënyrat se si mund të zhvillohet një seancë gjyqësore.

Rimerr fjalën *zonja Shehu* e cila sqaron faktin se Këshilli nuk mund të funksionojë më vete, pra nuk mund të veprohet as qoftë me cilësinë e anëtarit, pa marrë miratimin e anëtarëve të tjerë.

Për ta përmbyllur merr fjalën *zotin Toska* i cili shprehet se iniciativa e zotit Muharremaj kishte qëllim të mirë dhe se në cilësinë e anëtarit ai nuk ka marrë ndonjë vendimmarrje, prandaj diskutimet janë të tepërta.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë nën asistencën e specialistëve të Misionit
EURALIUS)*

(Mbajtur, më 16.04.2020)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të gjyqtares znj. {...}”, përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:16 dhe mbaroi në orën 15:54.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Ilir Toska* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)

9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
11. *Marçela Shehu* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtoreshë pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
5. *Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të gjyqtarës znj. {...}”, përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Ilir Toska.

Merr fjalën zoti Ilir Toska i cili relaton relacionin shpjegues lidhur me përmbajtjen e projektvendimit: “Për caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të gjyqtarës znj. {...}”.

Zoti Toska shprehet se sipas vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 286, datë 18.12.2019 Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda është emëruar Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe po atë ditë, duke qenë përpara detyrimit ligjor, caktoi në mënyrë të përkohshme në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, gjyqtarën znj. {...} dhe ende nuk kishte një vendim të formës së prerë për konfirmimin e saj në detyrë. Ndërkohë me vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 234, datë 04.02.2020,

vendim ky që ka marrë formë të prerë pa u ankimuar, gjyqtarja ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit, për rrjedhojë Këshilli i Lartë Gjyqësor ka detyrimin që në zbatim të nenit 162/2 të ligjit për Statusin të bëjë caktimin në pozicion në mënyrë të përhershme në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të gjyqtares znj. {...}.

Anëtarët e Këshillit për këtë çështje të rendit të ditës nuk kanë diskutime, pyetje apo sugjerime, prandaj hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit propozimi i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës mbi projektvendimin “Për caktimin e përhershëm në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të gjyqtares znj. {...}”, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Illir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim Këshilli vendosi: Caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, të gjyqtares znj. {...} pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë nën asistencën e specialistëve të Misionit
EURALIUS)*

(Mbajtur, më 16.04.2020)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të gjyqtarit z. {...}”, përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:16 dhe mbaroi në orën 15:54.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. **Naureda Llagami** (kryetare)
2. **Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
3. **Medi Bici** (anëtar)
4. **Fatmira Luli** (anëtare)
5. **Brunilda Kadi** (anëtare)
6. **Dritan Hallunaj** (anëtar)
7. **Ilir Toska** (anëtar)
8. **Alban Toro** (anëtar)

9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
11. *Marçela Shehu* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtoreshë pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
5. *Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të gjyqtarit z. {...}”, përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Ilir Toska.

Merr fjalën zoti Ilir Toska i cili relatton relacionin shpjegues lidhur me përmbajtjen e projektvendimit: “Për caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të gjyqtarit z. {...}”.

Zoti Toska shprehet se sipas vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 286, datë 18.12.2019 Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda është emëruar Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe po atë ditë, duke qenë përpara detyrimit ligjor, caktoi në mënyrë të përkohshme në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, gjyqtarin z. {...} dhe ende nuk kishte një vendim të formës së prerë për konfirmimin e tij në detyrë.

Ndërkohë me vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr.218, datë 10.12.2019, vendim ky që ka marrë formë të prerë pa u ankimuar, gjyqtari ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit, për rrjedhojë Këshilli i Lartë Gjyqësor ka detyrimin që në zbatim të nenit 162/2 të ligjit për Statusin të bëjë caktimin në pozicion në mënyrë të përhershme në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të gjyqtarit z. {...}.

Anëtarët e Këshillit për këtë çështje të rendit të ditës nuk kanë diskutime, pyetje apo sugjerime, prandaj hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit propozimi i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës mbi projektvendimin “Për caktimin e përhershëm në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të gjyqtarit, z. {...}”, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Illir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim Këshilli vendosi: Caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, të gjyqtarit z. {...} pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë nën asistencën e specialistëve të Misionit
EURALIUS)*

(Mbajtur, më 16.04.2020)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi miratimin e fondeve të lira, nga buxheti i vitit 2020, në sistemin gjyqësor”, përgatitur nga anëtarët: z.Toro, z. Qoku, znj. Shehu, znj. Kadi, etj.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:16 dhe mbaroi në orën 15:54.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 7. Ilir Toska** (anëtar)
- 8. Alban Toro** (anëtar)
- 9. Brikena Ukperaj** (anëtar)

10. Erjon Muharremaj (anëtar)

11. Marçela Shehu (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 5. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi miratimin e fondeve të lira, nga buxheti i vitit 2020, në sistemin gjyqësor”, përgatitur nga anëtarët: z.Toro, z. Qoku, znj. Shehu, znj. Kadi, etj.

Çështja lidhur me miratimin e fondeve të lira, nga buxheti i vitit 2020, në sistemin gjyqësor, vjen për trajtim në mbledhje me dy propozime. Njëri propozim vjen nga disa anëtarë të Këshillit dhe propozimi tjetër vjen nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Fillimisht i jepet fjala zotit Toro, si iniciues i projekt-aktit.

Zoti Toro merr fjalën dhe shprehet mbi qëllimin e kësaj iniciative kut thekson se vendi po kalon një situatë të vështirë si pasojë e përhapjes së infeksionit nga Coronavirusi i ri Covid-19. Në këto kushte disa anëtarë propozojnë rialokimin e fondeve në disa zëra të buxhetit të KLGJ për vitin 2020 me qëllim që t’iu vihen në dispozicion/t’i propozohet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Konkretisht vlerësohet se:

Shpenzimet për vaj dhe karburant (deri në fund të vitit) - Prokurimet publike janë pezulluar dhe në thesar nuk kalon asnjë shpenzim operativ përveç pagave dhe shpenzimet që kanë lidhje me pandeminë;

Shpenzimet në vlerë monetare e parashikuar për lëvizjet jashtë vendit – Është

parashikuar që në 6 muajt në vijim të mos ketë lëvizje të individëve jashtë vendit;

Shpenzime për investime – Duke mos ditur fillimin e funksionimit të selisë së re, do të jetë edhe ky një nga zërat që nuk do mund të realizohet deri në fund të vitit, por zoti Toro shton që është propozuar që vetëm zëri i sistemit të menaxhimit të dokumentave mos të preket, pasi është një fond i domosdoshëm i cili duhet të ezaurohet.

Ndërsa sa i përket alokimit të fondeve në disa zëra të buxhetit të gjykatave, zoti Toro ndalet sa i përket fondit që ka Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës në lidhje me studimin urbanistik për gjykatën e re që do ndërtohet. Ky fond ka një pengesë kryesore pasi, ende nuk ka përfunduar harta e re gjyqësore dhe në këto kushte, mendohet që ky investim nuk mund të realizohet deri në fund të vitit. Në mënyrë të përmbledhur ky është propozimi i ardhur nga disa anëtarë të Këshillit lidhur me alokimin e këtyre fondeve, fonde të cilat t'u vihen në dispozicion Ministrisë së Financave.

Më pas, merr fjalën zonja Llagami e cila shprehet se me kërkesën e depozituar në mënyrë elektronike më datë 11 prill, Ministria e Financave i ka kërkuar Këshillit të reagojë lidhur me mospërdorimin e shpenzimeve për shkak të ngadalësimit të aktivitetit. Bazuar në këtë shkresë, Departamenti i Financës pranë KLGJ-së ka përgatitur një material me informacion mbi buxhetin e KLGJ-së dhe mbi buxhetin e 38 gjykatave të vendit. Zonja Llagami shton se qëllimi i këtij informacioni është rivlerësimi i mundësisë së alokimit të fondeve pranë Ministrisë së Financave, duke qenë se KLGJ-ja dhe 38 gjykatat në vend nuk mund të funksionojnë në mënyrë të plotë në këtë periudhë pandemie.

Propozimi i ardhur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit mbi alokimin e fondeve është më racional dhe mbështetet në dy faktorë: funksionaliteti i KLGJ-së dhe funksionaliteti i sistemit gjyqësor.

Për më shumë detaje mbi propozimin e këtij Komisioni, Kryetarja e Këshillit i jep fjalën Drejtores së Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit zonjës Laze si dhe Drejtorit të Drejtorisë së Programimit dhe Monitorimit të Buxhetit zotit Haxhiu, për të bërë një përmbledhje të relacionit shpjegues mbi miratimin e këtyre fondeve.

Merr fjalën *zonja Luljeta Laze* e cila relatton relacionin shpjegues lidhur me projektvendimin “Mbi miratimin e fondeve të lira, nga buxheti i vitit 2020, në sistemin gjyqësor”.

Zonja Laze shprehet se pas ardhjes së shkresës nga Ministria e Financave dhe administrimit të informacionit, Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit ka dalë me disa propozime konkrete. Fillimisht, sa i përket programit të KLGJ-së tek shpenzimet e personelit propozohet që të jepen 10 milion lekë, duke qenë se ka mungesë në burime njerëzore. Sipas një analize të bërë nga ky Departament, sa i përket fondeve mbi shpenzimet operative të KLGJ-së, KLGJ-ja e ka të pamundur të kthejë fonde të lira, pasi ndër të tjera, ka një detyrim të cilin nuk e kishte të parashikuar në detajimin e fondit të buxhetit të dhjetorit 2019 (fondi me vlerë 60 milion lekë), detyrim që ka lidhje me një vendim ekzekutimi të gjykatës mbi pagesën e magjistratëve detyrim i cili ka lindur pas detajimit të fondeve miratuar në KLGJ në dhjetor të vitit 2019, pra është një shpenzim tepër që duhet ende të kryhet.

Zoti Toro merr fjalën dhe shprehet se kjo pagesë e cila duhet të shlyhet nga KLGJ kundrejt magjistratëve, mund të parashikohet në detajimin e buxhetit për vitin 2021. Ai shprehet se çdo institucion shtetëror, një detyrim të cilin e ka këtë vit, e parashikon për vitin që vjen dhe më pas e ekzekuton. Në përgjigje, *zonja Laze* shprehet se ky vendim për ekzekutim është ndryshe nga vendimet e tjera, pasi ka lidhje me pagat e magjistratëve dhe mendon gjithashtu që të ketë një iniciativë ligjore sa i përket pagesave, pagesë të cilën magjistratët ta marrin në momentin që ata të emërohen gjyqtarë. Gjithashtu zonja Laze shprehet se Përmbartimi mund të bllokojë veprimtarinë (llogarinë e thesarit).

Zonja Laze vijon më tej me rralimin, sa i përket zërit të shpenzimeve për investimet në KLGJ, propozohet që fondit i cili ishte lënë i veçantë për shpenzime të paparashikuara, të konsiderohen si fonde të lira.

Për sa i përket programit të gjykatave, pas mbledhjes së informacionit nga të gjitha gjykatat, propozohet që në shpenzimet e personelit të ketë një fond të lirë prej 52

milion e 984 mijë lekë pasi në gjykata ka mungesë të theksuar në burimet njerëzore, duke u mbajtur në konsideratë vendet vakante të shpallura për Gjykatën e Lartë. Ndër të tjera është mbajtur në konsideratë këtu edhe një shkresë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë e cila ka shprehur nevojën për fonde shtesë për shkak të vendimit mbi pagesën e gjyqtarit Osman Aliu, i cili nëse nuk paguhet deri në fund të vitit, ai humb të drejtën e pensionit për shkak të mospagesës së sigurimeve shoqërore.

Sa i përket shpenzimeve operative, propozohet që fondi i lirë të jetë për një periudhë 6-mujore. Një pjesë e fondit, gjykatave do t'u duhet për të kryer procesin e dezinfektimit në momentin e fillimit të veprimtarisë të tyre, duke garantuar një veprimtari të qetë dhe normale në 6-mujorin e dytë.

Sa i përket shpenzimeve kapitale, propozohet që fondi i investimit të gjykatave të mos preket, pasi fondi i investimeve ka të bëjë me zhvillimin infrastrukturor në tërësi të gjykatave, duke përfshirë këtu nevoja për pajisje elektronike, pajisje zyre, siguria në gjykata, projekti i Gjykatës së Durrësit. Zonja Laze shton se ende nuk është detajuar një buxhet sa i përket fondit mbi dëmtimin e gjykatave nga tërmeti i 26 nëntorit pasi Këshilli mbetet në pritje të një konfirmimi nga Ministria e Financave. Gjithashtu mendohet që situata e buxhetit për vitin 2021 të jetë shumë e vështirë, prandaj për mirëfunksionimin e gjykatave dhe zhvillimin e tyre, mendohet që ky fond të mos preket.

Pas relatimit të zonjës Laze, merr fjalën **zonja Kadi** për të drejtuar një pyetje në lidhje me çfarë ndodh nëse nuk harxhohen 100 milion lekë për t'u bërë vizatimi apo projekti i Gjykatës së Durrësit dhe nëse ky projekt nuk bëhet, çfarë ndodh me funksionimin e gjyqësorit? Gjithashtu zonja Kadi shton edhe faktin që sot ende nuk ka një hartë gjyqësore dhe nuk dihet se si do të jetë Gjykata e Durrësit dhe lind pyetja se nëse nga harta gjyqësore del diçka tjetër, a mund të përdoret ky projekt?

Në përgjigje, **zonja Laze** shprehet se çështja e investimeve nuk është një çështje që bëhet sot për sot. Nëse ky projekt nuk arrihet të bëhet brenda këtij viti, nuk mund ta kërkojë këtë buxhet për ta filluar vitin tjetër, pasi ndërtimi i një godine nuk mund të bëhet me fondet e një viti.

Rimerr sërish **zonja Kadi** fjalën duke dhënë kazusin e tillë sikur projekti i Gjykatës së Durrësit do të realizohet, pra do të shpenzohen paratë për projektin e kësaj gjykate, ndërkohë harta e re gjyqësore konkludon që Gjykata e Durrësit nuk do bëhet ose do bëhet diku tjetër ose zonja Kadi jep një kazus tjetër, sikur qeveria të mos miratojë fondin e bërjes së këtij projekti, kush do të mbajë përgjegjësi për këto 100 milion lekë? Ndërkohë zonja Kadi mendon se duhet të jetë në ndërgjegjen e çdokujt që të mos aprovojë që shteti shqiptar në këtë kohë pandemie të harxhojë 100 milion lekë për projektin e një godine me të gjitha këto risqet që u përmendën më lart.

Zonja Laze shprehet se sipas parashikimeve, mendohet që Gjykata e Durrësit nuk është nga ato gjykata të cilat parashikohet të hiqet nga harta e re gjyqësore.

Zonja Llagami rishpjegon edhe një herë shqetësimin që ngriti zonja Kadi: Nëse eventualisht harta e re gjyqësore vendos që Gjykata e Durrësit nuk do të jetë pjesë e hartës gjyqësore, atëherë çfarë do të ndodhë me këtë fond? –Digjet?

Zonja Kadi ndërhyt për të bërë një korigjim, pasi pyetja e saj ishte nëse harxhohet ky fond dhe gjithashtu, shtron edhe një tjetër pyetje sa i përket eventualitetit që harta gjyqësore mbyllet brenda vitit dhe bën sens që të vijohet me projektin, por nëse harta gjyqësore nuk konkludon brenda vitit, ky fond që nuk ekzekutohet, mund të kalojë vitin tjetër? Sipas zonjës Kadi, nuk bën sens që ky fond të mbahet, përderisa sipas mendimit të saj, harta nuk konkludon brenda vitit.

Në përgjigje të sa më lart, **zonja Laze** jep mendimin se fondet e investimeve nuk mund të jepen pasi ato janë shumë të rëndësishme për zhvillimin në tërësi të infrastrukturës së gjykatave. Projekti nuk mund të fillojë pa patur të gjithë treguesit që i duhen për fillimin e tij. Pra pa mbarimin e hartës së re gjyqësore, nuk mund të fillojë projekti i Gjykatës së Durrësit.

Zonja Llagami merr fjalën për të pyetur nëse Ministria e Financave ka kërkuar fonde të tilla në shkresën e saj? Nëse nuk i ka kërkuar, a mundet t'i kërkojë më pas? Gjithashtu zonja Llagami shprehet se duke qenë se Gjykata e Durrësit është një gjykatë që është futur në prioritetet e planit strategjik, a do ishte korrekte që Këshilli të heqë dorë nga prioritetet e tij pa ia kërkuar këtë gjë Ministria e Financave?

(Duke qenë se realizimi i mbledhjes bëhet i mundur nëpërmjet programit Microsoft Team, ka ndërprerje herë pas herë të audios dhe komunikimi i anëtarëve me dy përfaqësuesit e administratës së Këshillit bëhet i vështirë.)

Merr fjalën **zoti Haxhiu** i cili plotëson përgjigjen e dhënë nga zonja Laze në lidhje me investimin e Durrësit. Në fjalën e tij ai shton se buxheti i shtetit, kur hartohet, hartohet për një vit buxhetor dhe një nga parimet e tij është 'parashikueshmëria'. Këto fonde janë parashikuar në fillim të vitit për t'u përdorur pavarësisht se një pjesë e mirë e tyre nuk janë përdorur prej shumë faktorësh.

Sa i përket hartës së re gjyqësore, zoti Haxhiu hamendëson sikur ajo nuk do të miratohet, paratë janë aty dhe nuk digjen. Ndërkohë është edhe opsioni tjetër që mund të miratohet harta dhe sa i përket projektit të Gjykatës së Durrësit, mundet që ky projekt të shkojë kudo, për çdo gjykatë.

Sa i përket fondit të investimit, zoti Haxhiu sqaron se Ministria e Financave si ministria përgjegjëse për administrimin e buxhetit në Republikën e Shqipërisë, i lind e drejta edhe në një vit buxhetor pa fatkeqësi natyrore, që të kërkojë rezervat.

Zonja Kadi bën një ndërhyrje dhe kërkon të sqarohet sa i përket rastit se çfarë ndodh me fondin nëse harta gjyqësore nuk miratohet brenda këtij viti dhe projekti nuk ekzekutohet, ky fond digjet apo mund të rialokohet për nevoja të tjera.

Dhe përgjigjja nga **zoti Haxhiu** është se fondi nuk digjet deri në fund të vitit buxhetor, pra deri më datë 31 dhjetor. Nëse lind e nevojshme, Këshilli mund t'i rialokojë këto fonde. Zoti Haxhiu sqaron që këto fonde digjen nëse nuk realizohet projekti i

Gjykatës së Durrësit deri në fund të vitit.

Ndërsa sa i përket financave, nëse ky fond mund të kërkohet apo jo nga Këshilli për vitin tjetër buxhetor, zoti Haxhiu sqaron se kushtet janë shumë të këqija kjo pasi edhe Fondi Monetar Ndërkombëtar raporton për Shqipërinë se ekonomia do të jetë në ulje me - 5%.

Pas këtyre sqarimeve, merr fjalën **zoti Erjon Muharremaj** i cili pyet nëse është e mundur që fondi i parashikuar për projektin e Gjykatës së Durrësit, në eventualitetin që Këshilli do të jetë në pamundësi të paguaj pagat e gjyqtarëve në zbatim të vendimit të formës së prerë, të shkojë për të ekzekutuar vendimin gjyqësor?

Zoti Haxhiu në përgjigje të pyetjes së zotit Muharremaj shton se ka një problem në rialokimin e fondeve nga një program në tjetrin, rialokim i cili bëhet vetë me vendim të Ministrit të Financave.

Pyetjes së **zonjës Ukperaj** nëse a mundet të kërkojë Ministria e Financave që të kalonin në buxhetin e shtetit të gjitha fondet e parashikuara për investime, zonja Laze përgjigjet se Ministria e Financave nuk kërkon, por i merr fondet që do he në situata të jashtëzakonshme shkon deri në ato pika sa edhe të limitohen pagat, etj. Zonja Laze është e mendimit që ky fond mos të lihet i lirë, pasi situata është e panjohur dhe nuk dihet sa do zgjasë dhe sqaron që departamenti pranë KLGJ-së do bëjë një analizë në fund të gjashtëmujorit.

Më tej shton zonja Ukperaj që edhe projekti për hartën ka qenë një parashikim, ashtu si edhe buxheti. Për Gjykatën e Durrësit ka dalë me një parashikim duke thënë që Gjykata e Durrësit nuk lëviz, por do bashkohet ndoshta me gjykata të tjera. Zonja Ukperaj mendon që mundësia e vlerësimit ekziston pasi ka ende 6 muaj të tjerë viti. Ndërkohë zonja Ukperaj propozon që shpenzimet mbi investimet në gjykata mos të merren parasysh sot, pra të lihet në një moment të dytë për t'u diskutuar, pasi ngre shqetësimin e shpenzimeve të paparashikuara nga gjykatat si për shembull shpenzimet

mbi dezinfektimin e gjykatave në momentin e rifillimit të veprimtarisë së tyre. Gjithashtu ngre edhe shqetësimin e 21 magistratëve të cilët do të futen në sistem në shtator.

Në përgjigje të çka u tha nga zonja Ukperaj, **zonja Laze** sqaron se me detajimin e buxhetit në dhjetor është lënë një fond rezervë për punonjësit që do merreshin shtesë dhe për magistratët që do të emërohen. Ndërsa sa i përket investimeve dhe projektit të Gjykatës së Durrësit, zonja Laze rithekson që është bërë përpjekje e madhe disavjeçare që të arrihet të ndërtohet ky projekt dhe prandaj janë me propozimin që këto fonde mos të lihen të lira.

Zoti Qoku merr fjalën dhe jep gjykimin e tij sa i përket propozimit të bërë nga anëtarët e Këshillit, pra aktit të parë të kësaj çështjeje, ku një ndër propozuesit është edhe ai vet, dhe sqaron se ai ka vlerësuar se duke qenë se qeveria sot po përballej me këtë pandemi, gjykoi që nëse Këshilli, me vullnet, gjen fonde të lira dhe ia vë në dispozicion qeverisë, nesër, kur ky pushtet të përmirësohet, të mund t'i kthejë përsëri.

Gjithashtu, zoti Qoku kërkon që zyra e buxhetit të heqë dorë nga analiza juridike e problemeve dhe të mbeten tek aspekti financiar, të marrin dijeni nga Këshilli apo edhe miratimin e tij, pasi nëse Ministria e Financave, drejtohet zyrës së buxhetit, nuk do të thotë që u drejtohet atyre, por i drejtohet Këshillit. Prandaj zoti Qoku kërkon që Këshilli të vihet në dijeni për të gjitha kërkimet dhe komunikimet që kryen zyra e buxhetit dhe pas miratimit nga ana e Këshillit, të veprohet. Për zotin Qoku kjo është esenciale, pasi shkohet në shpërdorim detyre dhe shkelje të ligjit.

Zonja Llagami merr fjalën për të sqaruar mbi vendimmarrjen e Këshillit kundrejt kërkesës së Ministrisë së Financës, e cila ka qenë përpara nismës së kërkuar nga zoti Toro sepse në mënyrë qarkulluese ne i kemi dhënë Ministrisë së Financave të gjithë pagat që kishim të lirshme në ato momente dhe më pas ka lindur kërkesa e zotit Toro. Ndërsa lidhur me komunikimin e stafit administrativ me institucionet e tjera, zonja Llagami sqaron se stafi administrativ nuk komunikon pa miratimin e Këshillit dhe rasti në fjalë kishte të bënte me një kërkesë e ardhur ditën të shtunë për shkak të situatës emergjente të

pandemisë.

Zonja Fatmira Luli merr fjalën dhe sqaron mbi qëndrimin e saj kundër të mbajtur në Komision mbi projektin e Gjykatës së Durrësit duke qenë se situata është e vështirë dhe harta gjyqësore ende s'ka përfunduar dhe do të ishte një shpenzim shumë i madh. Ndërsa për shpenzimet operative zonja Luli është e mendimit që të mos jepen për të gjitha arsyet që u dhanë më sipër, pra që të mos pengohet funksionalizimi i gjykatave.

Zoti Hallunaj merr fjalën për t'i drejtuar një pyetje anëtarëve të cilët kanë propozuar aktin e parë në lidhje me arsyet që çoi këta anëtarë për iniciativën që morën, pasi sipas zotit Hallunaj edhe sistemi i drejtësisë ka nevoja për buxhetin.

Zoti Toro shprehet se kjo iniciativë erdhi për t'iu përgjigjur pozitivisht pandemisë. Gjithashtu edhe **zonja Shehu**, si një nga anëtarët propozues të këtij akti, i përgjigjet zotit Hallunaj duke shprehur se arsyeja ka qenë pikërisht propozimi i tyre për të përfshirë në rendin e ditës rikonsiderimin edhe një herë të buxhetit të shtetit me qëllim rialokimin Ministrisë së Financave bazuar në situatën dhe gjendjen e vështirë ekonomike që gjendet vendi. Gjithashtu zonja Shehu flet edhe për thirrjen e Kuvendit për përgjysmimin e pagave, thirrje të cilës i janë përgjigjur pozitivisht 6 anëtarë.

Gjithashtu edhe **zonja Luli** merr fjalën në lidhje me pyetjen e ngritur nga zoti Hallunaj duke u shprehur se edhe heqja dorë e të mirave materiale për shkak të detyrës, si karburanti për shembull, ishte një sakrificë ndaj mbështetjes së qeverisë në këtë gjendje emergjence.

Edhe **zoti Medi Bici** është një ndër propozuesit për rishikimin e fondeve duke mbështetur kërkesën e ardhur nga Ministria e Financave, duke qenë kështu dakord me raportin e përgatitur nga zyra e buxhetit në KLGJ.

Në vijim edhe **zonja Ukperaj** merr fjalën për të folur mbi kauzën që prek gjithë

vendin në këtë pandemi. Çështja e pagës është një thirrje personale dhe nuk ka lidhje me pjesën e rishikimit të buxhetit. Zonja Ukperaj sqaron se fillimisht është kërkuar nga një pjesë e anëtarëve rishikimi i buxhetit të KLGJ-së dhe i të gjithë gjykatave, dhe normalisht ka ardhur një informacion nga zyra e buxhetit për sa i është kërkuar, por kjo gjë duhej të bëhej vetëm me kërkesë të Ministrisë së Financave dhe jo vullnetarisht. Siç edhe është sqaruar më lart, jo kërkesë është lënë dhe nuk është trajtuar më tej, deri në momentin që doli problemi i pagave. Zonja Ukperaj shprehet se ndjeshmëria është edhe ndaj buxhetit të gjykatave edhe pse fillimisht ajo ka kërkuar të përgjysmohej paga e saj, kjo edhe për shkak të kushteve ekonomike të saj. Në përfundim të fjalës së saj, propozon që shpenzimet operative të gjykatave që kanë ardhur si propozim i Komisionit, të hiqet.

Zonja Shehu rimerr fjalën duke pyetur nëse është prezantuar vullneti i secilit anëtar në lidhje me këtë sensibilizim? A është reflektuar vullneti që me cilësinë e anëtarit është shprehur vullneti në lidhje me një çelje të një llogarie për të kontribuar vullnetarisht punonjësit e Këshillit, anëtarët dhe gjyqtarët, për efekt të kësaj situatë? Kjo gjë nuk u reflektua. Pastaj zonja Shehu flet mbi shkresën që i është dërguar Kuvendit të Shqipërisë mbi vullnetin e 6 anëtarëve të Këshillit për të përgjysmuar pagën, duke treguar kështu që pjesa tjetër e anëtarëve ishin të pandjeshëm ndaj thirrjes dhe shqetësimit të shqiptarëve. Ky ishte thelbi i diskutimit, duke propozuar që të fillohej nga pagat dhe të përfundohej tek buxheti i Këshillit.

Pas diskutimeve, pyetjeve dhe propozimeve lidhur me këtë çështje, hidhet në votim fillimisht nga Kryetarja e Këshillit akti i propozuar nga 5 anëtarët e Këshillit “Mbi miratimin e fondeve të lira, nga buxheti i vitit 2020, në sistemin gjyqësor”, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është kundër.

Illir Toska është kundër.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është kundër.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është kundër.

Brikena Ukperaj është kundër.

Medi Bici është kundër.

Naureda Llagami është kundër.

(7 (shtatë) anëtarë janë kundër propozimit të ardhur nga 5 anëtarët e Këshillit.

Propozimi nuk miratohet.)

Hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit propozimi i ardhur nga Komisioni i Përhershëm i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit “Mbi miratimin e fondeve të lira, nga buxheti i vitit 2020, në sistemin gjyqësor”, me propozimin e bërë gjatë seancës plenare nga dy anëtarët Brikena Ukperaj dhe Fatmira Luli për pikën 2 të propozimit, ku sugjerohet ndryshimi i vlerës për shpenzimet për mallra dhe shërbime të gjyqësorit në shumën 52,985 milion lekë (duke hequr shpenzimet operative të gjykatave), dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është kundër.

Brunilda Kadi është kundër pakësimit akoma edhe më shumë të fondit që duan të japin Ministrisë së Financave.

Dritan Hallunaj është dakord.

Illir Toska është dakord.

Alban Toro është kundër.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është kundër.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord, pavarësisht qëndrimit të Komisionit.

(7 (shtatë) anëtarë janë pro propozimit të ardhur nga 2 anëtarët e Këshillit për ndryshimin e pikës 2 të projekt-aktit të ardhur nga Komisioni. Propozimi miratohet.)

Hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit propozimi i ardhur nga Komisioni i

Përhershëm i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit “Mbi miratimin e fondeve të lira, nga buxheti i vitit 2020, në sistemin gjyqësor” në tërësi bashkë me ndryshimin e miratuar më lart, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është kundër.

Brunilda Kadi është dakord edhe pse votoi pro fillimisht për dhënien e një fondi më të madh.

Dritan Hallunaj është dakord.

Ilir Toska është dakord.

Alban Toro është kundër.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord edhe pse ishte pro fillimisht për dhënien e një fondi më të madh.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim Këshilli i Lartë Gjyqësor, vendosi: 1. Miratimin e fondeve të lira, nga buxheti i vitit ushtrimor 2020, në programin 01110, “Planifikim, Menaxhim, Administrim” buxheti i KLGJ-së, për shumën prej 23 000 000 (njëzetë e tre milion) lekë, sipas pasqyrës nr.1, bashkëlidhur.

2. Miratimin e fondeve të lira, nga buxheti i vitit ushtrimor 2020, në programin 03310, “Buxheti gjyqësor” buxheti i Gjykatave, për shumën prej 52 984 000 (pesëdhjetë e dy milion e nëntëqind e tetëdhjetë e katër mijë) lekë, sipas pasqyrës nr.2, bashkëlidhur.

3. Fondet e lira të miratuara, t’i dërgohen në dispozicion Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në kuadër të rishikimit të Buxhetit të Shtetit, për shkak të situatës së krijuar nga epidemia e virusit Covid-19.

4. Me zbatimin e këtij Vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit,

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të

Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë nën asistencën e specialistëve të Misionit
EURALIUS)*

(Mbajtur, më 16.04.2020)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:16 dhe mbaroi në orën 15:54.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)

10. Erjon Muharremaj (anëtar)

11. Marçela Shehu (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 5. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*

RENDI I DITËS:

6. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Ilir Toska.

Zoti Toka fillimisht propozon mbi radhën e hedhjes së shortit sipas këtyre gjykatave: Fillimisht do të hidhet shorti për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë, më pas Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet dhe në fund Gjykata e Apelit Korçë.

Pasi anëtarët e Këshillit janë dakord me propozimin e zotit Toska për radhën e shortit, vijohet me relatimin e relacionit të parë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe

numri i gjyqtarëve të jetë 1.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, konkretisht: z. Arben Dosti si dhe gjyqtari kësaj gjykate që është caktuar më herët në shortin e datës 30.03.2020 në një gjykatë tjetër të ndryshme, konkretisht: znj. Suela Dashi.

Anëtarët e Këshillit janë dakord me këto propozime të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik, i cili mundësohet nga specialistë të Misionit EURALIUS dhe nga specialiste znj. Valbona Bako.

Nga shorti elektronik përzgjidhet gjyqtari Pëllumb Vehbi, i cili caktohet për të gjykuar çështjen e veçantë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të dytë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier dhe numri i gjyqtarëve të jetë 1.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e kësaj gjykate që janë caktuar më herët në gjykimin e kësaj çështjeje, konkretisht: znj. Matilda Shalla dhe znj. Igerta Hysi.

Anëtarët e Këshillit janë dakord me këto propozime të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet gjyqtari Piro Sot, i cili caktohet për të gjykuar çështjen e veçantë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të tretë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Korçë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Korçë** ka paraqitur nevojë

për 1 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore, të jetë Gjykata e Apelit Tiranë dhe numri i gjyqtarëve të jetë 1.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Tiranë, konkretisht: z. Ridvan Hado.

Anëtarët e Këshillit janë dakord me këto propozime të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet gjyqtari Zegjine Sollaku e cila caktohet për të gjykuar çështjen e veçantë në Gjykatën e Apelit Korçë.

Ndërkohë, gjatë kohës që hidhej shorti elektronik për tre gjykatat në nevojë, pranë Këshillit është administruar një kërkesë urgjente e ardhur nga Gjykata e Apelit Vlorë për shuarje mase. Duke qenë se edhe Këshilli është i mbledhur dhe aktualisht po trajtohet çështja e caktimit të gjyqtarëve, i lihet disa minuta kohë administratës dhe zotit Toska që të përpilojnë relacionin përkatës dhe të hedhin të dhënat përkatëse në sistemin e hedhjes së shortit. Pas disa minutash, rimblidhet Këshilli për të trajtuar këtë kërkesë të ardhur nga Gjykata e Apelit Vlorë.

Vijohet me relatimin e relacionit të katërt “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Vlorë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Vlorë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore, të jetë Gjykata e Apelit Gjirokastër dhe numri i gjyqtarëve të jetë 3.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohet nga shorti kryetarit të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, konkretisht: z. Dritan Banushi.

Anëtarët e Këshillit janë dakord me këto propozime të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen gjyqtarët Irena Brahimi (relator) dhe Enton Dhimitri dhe Izet Salaj (anëtarë) të cilët caktohet për të gjykuar çështjen e veçantë në Gjykatën e Apelit Vlorë.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë nën asistencën e specialistëve të Misionit
EURALIUS)*

(Mbajtur, më 16.04.2020)

Pika 7 shtesë e rendit të ditës me objekt: Diskutime në lidhje me problematikën e adresuar nga Presidenti i Republikës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:16 dhe mbaroi në orën 15:54.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 7. Ilir Toska** (anëtar)
- 8. Alban Toro** (anëtar)
- 9. Brikena Ukperaj** (anëtar)
- 10. Erjon Muharremaj** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 5. Ann Trice, përfaqësuese e USAID-it.*
- 6. Erion Fejzulla, përfaqësues i USAID-it.*

RENDI I DITËS:

7 (shtesë). Diskutime në lidhje me problematikën e adresuar nga Presidenti i Republikës.

Sa i përket çështjes që u fut në rendin e ditës në fillim të mbledhjes, merr fjalën **zoti Toro** i cili rishpreh edhe një herë merakun e tij në lidhje me nënshkrimin e marrëveshjes për evadimin e çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Lartë nga ana e përfaqësuesit të kësaj gjykate z. {...}, pasi në opinion e tij, z. {...} i ka mbaruar mandati dhe në këto kushte nënshkrimi i tij do të ishte jo legjitim. Prandaj zoti Toro propozon që nënshkrimi i këtij Memorandumi të bëhet nga njëri nga gjyqtarët të cilët janë emëruar rishtazi në atë gjykatë, pra ta vendosin vetë gjyqtarët ose të nënshkruhet nga gjyqtari më i vjetër i emëruar atje.

Zonja Llagami merr fjalën për të bërë një sqarim sa i përket nënshkrimit dhe shton që ky nënshkrim mund të mos bëhet me datë 17 (pra nesër) për shkak të procedurave të brendshme të USAID-it, kjo nga një telefonatë të realizuar me znj. Ann dhe fton përfaqësues të “Drejtësi për të gjithë” (duke qenë se po e ndjekin mbledhjen nëpërmjet platformës) për të dhënë një përgjigje mbi datën e nënshkrimit të këtij Memorandumi.

Zonja Ukperaj ndërkohë shtron një pyetje në lidhje me objektin e kësaj çështjeje të rendit të ditës, pasi fillimisht u trajtua dhe u votua për t'u futur në rendin e ditës çështja e shkresës së Presidentit, ndërsa aktualisht po diskutohet kush do të nënshkruaj marrëveshjen.

Në lidhje me sa kërkoi Kryetarja e Këshillit, zoti Erion Fejzulla (përfaqësues i Misionit “Drejtësi për të gjithë” relaton atë çka Ann Trice shpreh në lidhje me datën e nënshkrimit të këtij Memorandumi dhe ajo çka zonja Ann shpreh është se në lidhje me problematikën e nënshkrimit brenda USAID-it nuk ka qenë çështja e vonesave por ka qenë çështja e papajtueshmërisë mes platformës së përdorur nga KLGJ-ja dhe platformës së përdorur nga USAID-i dhe prandaj është propozuar që në vend të nënshkrimit online të jetë një nënshkrim fizik nëpërmjet qarkullimit të dokumentit. Ndërsa në lidhje me shkresën e ardhur nga Presidenti i Republikës, znj. Trice shprehet se Këshilli duhet të vendosë ta trajtojë këtë shkresë dhe më pas Këshilli të thotë se cilët janë nënshkruesit e këtij Memorandumi nga ana e Gjykatës së Lartë.

Duke qenë një nga propozueset për t'u trajtuar kjo çështje në rendin e ditës, *zonja Kadi* shprehet se Këshilli më datë 10 mars i ka kthyer një përgjigje Presidentit të Republikës në lidhje me emërimin e anëtarëve të Gjykatës së Lartë, ku ndër të tjera i është thënë se me emërimin e gjyqtarit të parë nga juristët e spikatur (nga tre gjyqtarët që iu propozuan Presidentit të Republikës), zoti {...} duhet të dorëzonte detyrën pasi mandati i ka mbaruar në 24 shkurt 2014, detyrë të cilën do e ushtronte deri në momentin që do i vinte zëvendësi i parë. Gjithashtu zonja Kadi shprehet se edhe akti formal i mbarimit të mandatit është ezauruar në vitin 2014 kur kryetari i Gjykatës së Lartë në atë kohë, zoti {...} ka njoftuar Presidentin e Republikës për mbarimin e mandatit dhe fillimin e procedurave.

Zonja Kadi propozon që nga ana e Këshillit, t'i kërkohet zotit {...} që ta dorëzojë detyrën si dhe t'u kërkohet tre anëtarëve të Gjykatës së Lartë, që sipas parashikimeve ligjore, mes tyre të zgjedhin zëvendësin, pasi Gjykata e Lartë nuk mund të rrijë pa një drejtues.

Zoti Toska merr fjalën për të shtuar se problematikat që Presidenti i Republikës ngre në shkresën e tij janë të rëndësishme dhe sensitive, por çështja që diskutohet është çështja e zgjidhjes. Për efekt edhe të ligjit, zoti Toska propozon që kjo çështje duhet të ketë fillimisht një relator (sipas nenit 67 të ligjit 115/2016) i cili të japë propozime konkrete dhe më pas secili nga anëtarët e Këshilli diskuton mbi pasjen apo jo të mandatit të zotit {...}.

Zoti Hallunaj merr fjalën në vijim të asaj që tha edhe zoti Toska dhe shpreh të njëjtin mendim, pra që të caktohet një relator nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i cili të adresojë në Këshill problematikat dhe propozimet.

Në vijim, anëtarët e Këshillit diskutojnë mbi çështjen e kompetencës së përpilimit të këtij akti, dhe zoti Toska mendon se problematikat e shkruara në shkresën e Presidentit të Republikës nuk janë çështje të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, ndërsa zonja Kadi mendon të kundërtën, duke qenë se ky Komision ka trajtuar edhe mandatet e gjyqtarëve të tjerë të Gjykatës së Lartë. Por edhe në këtë rast zoti Toska shprehet se referuar ligjit, në rastin e ish-anëtarëve të tjerë të Gjykatës së Lartë të cilët kishin mbaruar mandatin dhe kishin dorëzuar detyrën, KZHK ka konsideruar të zbatojë të drejtën e tyre duke i caktuar në nivel apeli.

Duke shprehur mendimin e saj pro propozimit të zotit Toska që të caktohet një relator nga anëtarët e Këshillit për të trajtuar shkresën e ardhur nga Presidenti i Republikës dhe duke parashtruar variantet e mundshme mbi qëndrimin që duhet të mbajë Këshilli, zonja Shehu propozon gjithashtu që procedurat e nënshkrimit të Memorandumit të pezullohen deri në vlerësimin përfundimtar të kësaj çështjeje nga ana e Këshillit.

Edhe **zonja Ukperaj** është pro propozimit të bërë nga zoti Toska, për të caktuar një relator për ta trajtuar çështjen qoftë nga pikëpamja procedurale ashtu edhe nga pikëpamja materiale. Ndërsa lidhur me pezullimin e procedurës së nënshkrimit të

Memorandumit, meqenëse edhe nga USAID u tha që të pritët vendimmarrja e Këshillit, zonja Ukperaj shprehet se nuk është e nevojshme të shprehet Këshilli për pezullimin e këtij procesi.

Pas diskutimeve edhe një herë të trajtimit të kësaj çështjeje nga një relator apo Komision i caktuar, diskutime të bëra nga zoti Toska dhe zonja Kadi, ku zoti Toska është i mendimit që kjo çështje nuk i takon Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe mendimit të zonjës Kadi që kjo çështje i takon këtij Komisioni duke qenë se edhe shkresën e parë për Presidentin e Republikës e ka trajtuar ky Komision, që në fakt zoti Toska sqaron që është bërë nga Komisioni pasi shkresa kërkonte informacion mbi procedurën e ndjekur për emërimin e tre gjyqtarëve të propozuar Presidentit të Republikës për emërim, procedura të ndjekura dhe të kryera nga KZHK; pasi asnjë anëtar nuk doli vullnetar të jetë relator për këtë çështje; pas pyetjeve dhe propozimeve të shtruara më lart, hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit propozimi i parë, që trajtimi i kësaj çështjeje të bëhet nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Ilir Toska është kundër.

Alban Toro është kundër.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është kundër.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është kundër.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është kundër.

(6 (gjashtë) vota pro propozimit që kjo çështje do trajtohet nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.)

Ndërsa në lidhje me nënshkrimin e Memorandumit, **zonja Llagami** shprehet se

nënshkrimi i Memorandumit nuk do të kryhet deri në mbajtjen e një qëndrimi nga ana e Këshillit mbi shkresën e Presidentit të Republikës.

Me këtë çështje të rendit të ditës përfundon mbledhja e datës 16.04.2020.

* * *

(Pika 7 shtesë e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor